



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në mbështetje me nenin 47 paragrafi (1) pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18) dhe nenin 64 paragrafi (3) nga Ligji për Bankat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16, 7/19 dhe 101/19), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

VENDIM

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.181/19)

1. Në Vendimin për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/12, 50/13, 71/14, 223/15, 218/16 dhe 221/18), në pikën 6), nën-pika 12) paragrafin (3) nënparagrafi 3) ndryshohet dhe thotë: "Banka e Zhvillimit e Maqedonisë së Veriut".

2. Në pikën 6), nën-pika (24) ndryshohet dhe thotë:

"24) Për **rreziqet e tregut** konsiderohen:

- rreziku nga investimet në instrumentet pronësore që janë pjesë nga portofoli për tregtim;
- rreziku nga investimet në instrumentet e borxhit që janë pjesë nga portofoli për tregtim; dhe
- rreziku nga tejkalimi i kufijve të ekspozimit që rrjedh nga pozicionet në portofolin e tregtimit."

Në nën-pikën 31) fshihen fjalët: "në portofolin për tregtim". Nën-pika 32)

ndryshohet dhe thotë:

"32) **Rreziku nga pala tjetër kontraktuese** është rrezik se pala tjetër kontraktuese nuk do t'i shlyen detyrimet monetare të veta ndaj bankës në mbështetje të instrumenteve financiare, para ose në datën e shlyerjes."

3. Në pikën 27), paragrafi (1) ndryshohet dhe thotë:

"Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rreziqeve paraqet përmblendhje të:

- kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut të kredisë të përcaktuar në pajtim me kreun VI të këtij vendimi;
- kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut valutator të përcaktuar në pajtim me kreun VII të këtij vendimi;
- kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregut, të përcaktuar në pajtim me kreun VIII të këtij vendimi;

- kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga shlyerja/dorëzimi, të përcaktuar në pajtim me kreun VIII-a të këtij vendimi;
- kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga pala tjetër kontraktuese, të përcaktuar në pajtim me kreun VIII-6 të këtij vendimi;
- kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga ndryshimet e çmimeve të mallrave, të përcaktuar në pajtim me kreun IX të këtij vendimi; dhe
- kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ, të përcaktuar në pajtim me kreun X të këtij vendimi."

4. Në pikën 62 fjalët: "Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit", zëvendësohen me fjalët: "Banka e Zhvillimit e Maqedonisë së Veriut".

5. Në 66, pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), që thotë:

"Banka është e detyruar t'i zbatojë dispozitat e paragrafit (4) të kësaj pike për kreditë konsumatore me afat të dakorduar të maturimit të barabartë ose më të gjatë se tetë vjet të miratuara pas 1 janarit 2016, përfshirë edhe kreditë konsumatore tek të cilat banka ka vazhduar afatin e maturimit pas 1 janarit 2016, me ç'rast afati total i maturimit të kredisë, i përcaktuar si përmbledhje e afatit të dakorduar të maturimit më 1 janar 2016 dhe të gjitha vazhdimet e maturimit të kredisë është e barabartë ose më e gjatë se tetë vjet."

6. Në pikën 110), paragrafi (1) ndryshohet dhe thotë:

"Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregut paraqet përmbledhje të:

- 1) kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut të pozicionit, si përmbledhje e:
 - kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga investimet në instrumentet e borxhit, të përcaktuar në pajtim me kreun VIII.3 të këtij vendimi, dhe
 - kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga investimet në instrumentet pronësore, të përcaktuar në pajtim me kreun VIII.4 të këtij vendimi, dhe
- 2) Kapitalit të nevojshëm për mbulimin e tejkallimit të kufijve të ekspozimit, të përcaktuar në pajtim me kreun VIII.5 të këtij vendimi."

7. Në pikën 112), paragrafi (2) ndryshohet dhe thotë:

"Banka mund të kryejë netimin nga paragrafi 1 të kësaj pike, nëse bëhet fjalë për:

- pozicione të gjata dhe të shkurtra në instrument financiar të njëjtë të emetuar nga një person;
- pozicione të gjata dhe të shkurtra në instrumentet financiare të ndryshme të emetuara nga një person, vetëm nëse instrumentet financiare janë me prioritet të barabartë të arkëtimit (ang. seniority) ose instrumentet financiare në të cilën banka ka pozicion të shkurtër janë me prioritet më të ulët të arkëtimit nga instrumentet në të cilën banka ka pozicion të gjatë."

8. Në pikën 120 fjalët: "portofoli i instrumenteve financiare (ang. collective investment units)", zëvendësohen me fjalët: "pjesët në fondet investuese (ang. collective investment undertakings)".

9. Pika 139 ndryshohet dhe thotë:

"139. Kapitali i nevojshëm për mbulimin e tejkalimit të kufijve të ekspozimit fitohet me përfshirjen e këtyre pozicioneve në instrumentet e borxhit dhe instrumentet pronësore që kanë rrezik specifik më të lartë, në pajtim me kriterët VIII.3 dhe VIII.4 të këtij vendimi, të transaksioneve me instrumentet e borxhit, instrumente pronësore, valuta dhe mallra për të cilat përcaktohet kapitali për mbulimin e rrezikut të shlyerjes/dorëzimit, të përcaktuar në pajtim me kreun VIII-a të këtij vendimi dhe të instrumenteve financiare për të cilat përcaktohet kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga pala tjetër kontraktuese, të përcaktuar në pajtim me kreun VIII-6 të këtij vendimi.

10. Numri dhe titulli para pikës 142 ndryshohet dhe thotë:

"VIII-a. KAPITALI I NEVOJSHËM PËR MBULIMIN E RREZIKUT NGA SHLYERJA/DORËZIMI"

11. Në pikën 143, fjalët: "pozicioni nga portofoli për tregtim", zëvendësohen me fjalën: "transaksion".

12. Numri dhe titulli para pikës 145 ndryshohet dhe thotë:

"VIII-6. KAPITALI I NEVOJSHËM PËR MBULIMIN E RREZIKUT NGA PALA TJETËR KONTRAKTUESE"

13. Në pikën 145 paragrafi (1) fjali hyrës, fjalët: "grupe pozicionesh", zëvendësohen me fjalët: "instrumentet financiare".

Paragrafi (2) fshihet.

14. Në pikën 148, numri: "147" zëvendësohet me numrin: "146".

15. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", dhe do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2020.

Me përjashtim të paragrafit (1) të kësaj pike, pikat 1, 4, 5, 8 dhe 14 të këtij vendimi, do të fillojnë të zbatohen nga 30 shtatori i vitit 2019.

V nr.02-15/VIII-2/2019
29 gusht 2019
Shkup

Guvernatorja dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска